




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

06-05-2019				
Prapazi - Pismosje Kufizim				
Nr. i organit Org. broj	Numri/broj	q. n. e	q. n. e	Lloji Vërejtje
01-013/2009				



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2013, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN ZONË ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË NGASTRËS
KADASTRALE ME NR 3392-0 DHE NR 3393-3 NË ZONËN KADASTRALE NË VITI

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHPALLË zonë me interes të përgjithshëm pjesë të ngastrën kadastrale me nr. 3392-0 me sipërfaqe prej 62 m² dhe nr 3393-3 me sipërfaqe prej 12 m², në vendin e quajtur “oborr te shpija” Zonën Kadastrale në Viti të cilat janë në pronësi të Ridvan (Isuf) Sallahut nga Kabashi i Komunës së Vitisë.

Neni 2

Ngastrat kadastrale të shpallura zonë me interes të përgjithshëm nga neni 1 i këtij Vendimi, në Zonën Kadastrale në Viti do të këmbehen për zgjerimin e rrugës kryesore Viti – Kabash.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria e Inspektionit e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

